



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Gjilanit

Opstina Gnjilane
Municipality Gjilan
Gilan Belediyesi

Drejtoria për Rini, Kulturë e Sport

Qëllimi: Java e Rinisë 2011, Moto - “Kosova është e Re”

Java (Muaji i Rinisë) këtë vit hyn në vitin e dhjetë si aktiviteti më gjithëpërfshirës në sektorin e Rinisë në tërë Kosovën. Në organizim të Departamentit të Rinisë/MKRS dhe në partneritet me Drejtoritë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, ministritë tjera të Qeverisë së Republikës Kosovës, organizatat rinore dhe partnerët tjerë ndërkombëtar.

Java e Rinisë (Muaji i Rinisë) 2011 këtë vit, në dallim nga vitet e kaluara zhvillohet 7 ditë në 7 komuna, gjatë muajit shtator, ku komunat më të mëdha të Kosovës (Prizreni, Peja, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica, Gjilani dhe Prishtina) do të jenë nikoqire e kësaj feste.

Objektivat:

Promovimi i vlerave Rinore dhe angazhimi i të rinjve, në ndërtimin e shoqërisë së paqes dhe proceseve integruese, e gjithë kjo në frymën e tolerancës dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, Rritja e bashkëpunimit në mes të rinjve të të gjitha etniteteve dhe të rinjtë e grupeve të marginalizuara, në përgatitjen dhe ofrimin e një spektri të gjerë të aktiviteteve, Java e Rinisë (Muaji i Rinisë 2011) do t'i mobilizojtë rinjtë në tërë Kosovën rreth aktiviteteve të shumta që kanë për qëllim bashkëpunimin në mes të rinjve, sensibilizimin të opinionit për rolin e rëndësishëm të rinisë në shoqëri dhe përkushtimin e institucioneve dhe organizatave përkatëse ndaj këtij sektori. Ky projekt ka lidhshmëri me objektivat e MKRS/DiR, sic janë: ndërgjegjësimi dhe forcimi i pozitës së rinisë në shoqëri, angazhimin e të rinjve të të gjitha komuniteteve, ndërtimin e shoqërisë së paqës dhe proceseve integruese evropiane me synim, të bëhemi pjesë e Evropës.

Metodologjia e aktiviteteve:

Qasja metodologjike e këtij projekti është e bazuar në përvojat e mëhershme ku parimi kryesor është procesi i integritit dhe bashkëpunimit.

Të shtatë Komunat do t'i zhvillojë aktivitete e Javës rinor gjatë një dite të tërë, në datën e caktuar në përputhje me planin e organizimit sipas Projektit.

Vendi dhe kohëzgjatja e aktiviteteve:

Seri aktiviteteve gjatë muajit shtator dhe tetor / 7-ditë, në shtatë komunat e Kosovës,

ORARI I AKTIVITETEVE

1. Prizren 05.09.2011 e hënë,
2. Gjakovë 08.09. e enjete
3. Mitrovicë 12.09.e hene
4. Pejë 16.09.e premete
5. Ferizaj 19 . 09.e hene
6. **Gjilan 22.09.e enjete dhe**
7. Prishtinë 29. 09. 2011 e enjte

Programi : Me 22 dhe 26 shtator Gjilan 2011

- Aktivitet nga trashigimia Kulturore,-22.shtator (e enjete)

Ekspozite e hapur me moton:”Kosova është e re –Trashëgimia e vjeter”

Ora 11:00,

Vendi :sheshi “Agim ramadani”-Gjilan

- Debati me temen: Vullnetarizmi Rinorë

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora : 13.00

- Koncerti Argëtues-22.shtator (e enjete)

këngëtarët pjesëmarrësë do jenë(Dafina Rexhepi, Kaltrina Selimi, Freelancers, Dj Blunt & Real1, Kaos dhe Ryva Kajtazi etj...

Ora : 20:³⁰ – 23:³⁰,

Vendi: Qendër të Qytetit

- Aktivitet humanitar (dhurimi i gjakut) – 22.shtator(e enjte)

Ora 20:00 – 23:00, vendi Qendër të Qytetit-

transfuzioni mobil i dhurimit te gjakut

- Ekspozite eArtisteve vendore dhe nderkometare 26.shtator(e hene)

“ Salloni Vjeshtor 2011”

Vendi: Galeria e Qytetit-

Ora : 19.⁰⁰